



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 38 Prot

Tiranë, më 01, 03, 2011

VENDIM Nr. 142, dt. 01.03.2011

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 01.03.2011, mbasi shqyrtoi "Raportin përfundimtar mbi sondazhet arkeologjike të kryer në sheshin e pronë të B. Belegu, Shoqata "Dëshmitarët e Jehovahit", Familja Ismaili, K. Danaj, M. Dervishi, S. Tutra, A. Merdani, B. Sulejmani, S. Arapaj, D. Hoxha, P.Rama, Lagjja Nr. 7, Rruga "Vasil Mici", Durrës (Subjekti "Karaxha"sh.p.k.) - Agjencia e Shërbimit Arkeologjik

VENDOSI:

- I. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, Institutiti i Monumenteve të Kulturës dhe Institutit i Arkeologjisë të përgatisin kriteret e gërmimit arkeologjik të shpëtimit.
- II. Subjekti "Karaxha"sh.p.k, do të realizojë marrjen e propozimeve nga subjektet private të liçencuara për kryerjen e gërmimit arkeologjik të shpëtimit nën drejtimin e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe Institutit të Arkeologjisë.
- III. Gërmimi arkeologjik i shpëtimit do të fillojë pas përzgjedhjes nga grupi i punës i subjektit privat të liçencuar për kryerjen e gërmimit arkeologjik të shpëtimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

FERDINAND XHAFERAJ

MINISTËR

SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK